



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:191564

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05451171

CN.nr.137/2015

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtaren Njomëza Berisha, në çështjen juridiko-jo-kontestimore të propozuesit Sh.Th. nga Prizreni, kundër kundërpropozuesit S.M. nga Prizreni, sipas propozimit për ndarje fizike, me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore, për shkak të vdekjes së kundërpropozuesit S.M. nga Prizreni.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj kur trashëgimtarët e të kundërpropozuesit e marrin përsipër vazhdimin e procedurës apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Propozuesi Sh.Th. nga Prizreni, me datë 05.02.2015 pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim kundër kundërpropozuesit S.M. nga Prizreni, për shkak të ndarjes fizike.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje jo-kontestimore, ka caktuar seancë për shqyrtimin e propozimit me datë 07.03.2024. Me rastin e dërgimit të ftesave për seancë, për kundërpropozuesin Sadri Morina, ka ardh konstatimi në fletë kthesë se i njëjti ka ndërruar jetë.

Gjykata, me datë 07.03.2024, sipas detyrës zyrtare i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile në Prizreni, për të vërtetuar faktin e vdekjes për kundërpropozuesin. Me Aktin e datës 13.03.2024, të Zyrës së Gjendjes Civile në Prizren, gjykatës i është dorëzuar certifikata e vdekjes për kundërpropozuesin Sadri Morina.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, përkatësisht nga Certifikatë e vdekjes me nr. rendor 675, me nr. të referencës 20/2022RV/20001, me nr. Serik V 10667883, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prizren, me datë 13.03.2024, ka vërtetuar faktin se kundërpropozuesi S.M. (tani ish nga Prizreni), ka vdekur me datë 06.10.2022.

Me nenin 277 pika (a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), është paraparë se procesi gjyqësor ndërpritet *“kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale”*.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 3 të Ligjit të Procedurës Jo Kontestimore lidhur me nenin 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
CN.nr.137/2015 datë 14.03.2024**

**G j y q t a r j a
Njomëza Berisha**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.